



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 9036 Prot.

Tiranë, më 08.11. 2018

Nr. Identifikimi 839

Vendimi 52

### DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

#### VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Emri i Subjektit:** "PURA-MEDICAL" sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** L71515507M

**Adresa e selisë:** Ish Reparti i Kipit të Furnaltës, Kombinati Metalurgjik Elbasan

**Personi përgjegjës:** Jonida Balilaj

Për të zhvilluar projektin: "Asgjësim i mbetjeve spitalore me incenerim dhe autoklavë"

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I: Pika 9. Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve".

**Vendndodhja:** Ish reparti i Kepit të Furnaltës, Nr. Pasurie 348, Z.K 3965, Elbasan

**Të dhënat teknike:**

- Sipërfaqe e truallit: 704 m<sup>2</sup>
- Sipërfaqja e strukturës: 148 m<sup>2</sup>
- Kapaciteti i autoklavës: 1 000 kg/cikël
- Kapaciteti i inceneratorit: 20-30 kg/cikël

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:  
Drejtoria e Teknikës të Ministrisë shprehen:**

Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

**Drejtoria Rajonale e Mjedisit Qarku Elbasan Shprehet:** parimisht dakord për zhvillimin e aktivitetit dhe zbatimin e kushteve të parashikuara në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

**2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve iu siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

**3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

- Vendim i KM nr.798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"
- Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve"
- Udhëzimit Kombëtar të Administrimit të Sigurtë të Mbetjeve Spitalore"



- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23. 04. 2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme;
- Dorëzimi i mbetjeve sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 ”Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme;

**4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**

**4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**

- 4.2 Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqjes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.
- 4.3 Kjo Deklaratë lëshohet vetëm për asgjesimin e mbetjeve spitalore, lloji i të cilave përshkruhet në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
- 4.4 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore
- 4.5 Të respektohet norma e shkarkimeve në ajër sipas VKM Nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.
- 4.6 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.7 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe funksionimit, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.8 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.9 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.10 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga aksident.
- 4.11 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.12 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësi vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.13 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.14 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.15 Kapanoni i shkarkimit të mbetjeve dhe seleksionimit fillestar të jetë i shtruar me shtresa izoluese dhe fibra të posatshme që nuk lejojnë depërtimin në shtresat e tokës.
- 4.16 Trajtimi i mbetjeve në impiant të bëhet në një kohë sa më të shkurtër të mundshme duke ulur kohën e ekspozimit të tyre ndaj agjentëve të mjedisit



MBETARE E MJE

- 4.17 Ujërat e ndotura të gjitha kategorive të kapen e trajtohen në një impant të posatshtëm që do të jenë pjesë e projektit.
- 4.18 Subjekti të mbajë regjistër për sasinë e mbetjeve të trajtuara dhe të raportojë të dhënat çdo 6 muaj pranë Drejtorisë Rajonale të Mjedisit të qarkut përkatës.
- 4.19 Kapanoni dhe zona operationale të kenë sistem të mbledhjes së ujërave sipërfaqësore dhe orientimin e tyre në impjanit e trajtimit të ujërave të ndotura
- 4.20 Të merren masa për sigurimin teknik në ambjentet e kompanisë, të bëhet sistemimi ajrosja e ventilimi i ambjentit.
- 4.21 Transportimi dhe trajtimi i mbetjeve të kryhet vetëm nga subjekte të licensuara.
- 4.22 Grumbullimi, transportimi, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente shtetërore, personat juridikë publikë, si dhe personat fizikë apo juridikë privatë, që janë pajisur me lejen përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie
- 4.23 Para fillimit të procesit të punës subjekti duhet të hartojë një plan për administrimin e mbetjeve spitalore i cili duhet të rifreskohet cdo tre vjet.
- 4.24 Të bëhet trajnimi i personelit nga personel të çertifikuar, për marrjen e të gjitha masat e nevojshme të sigurisë;
- 4.25 Mbetjet spitalore duhet të ndajnë që në burim elementet e rrezikshme nga ato të parrezikshme të mbetjeve spitalore, sipas rregullores së brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore duke i magazinuar ato të ndara.
- 4.26 Në rast se në vendin e prodhimit apo gjatë transportit, mbetjet spitalore të rrezikshme në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme, përzihen me mbetje spitalore të parrezikshme, këto mbetje spitalore do të trajtohen si mbetje të rrezikshme.
- 4.27 Mbetjet spitalore të rrezikshme ambalazhohen dhe etiketohen në përputhje me shtojcën 2.A të Vendim i KM Nr.798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore” dhe magazinohen të ndara nga mbetjet e tjera.
- 4.28 Të tregohet kujdes për sigurinë e kontejnerëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe/ose të dekompozimit të tyre. Mbetjet njerëzore, shtazore apo të ndonjë gjallese tjetër të magazinuar për më shumë se 24 orë, por gjithsesi më pak se 48 orë nga ambalazhimi, duhet të ruhen në frigorifer ose hapësirë frigoriferike që përdoret vetëm për mbetjet spitalore në një temperaturë jo më të lartë se 10°C.
- 4.29 Mbetjet të jenë të etiketuara në mënyrë të dukshme me simbolin ndërkombëtar të biorrezikshmërisë të paraqitur në shtojcën 2.A të Vendimit të KM Nr.798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore” dhe magazinohen të ndara nga mbetjet e tjera.
- 4.30 Kontejnerët e mbetjeve të rrezikshme spitalore duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të etiketohen në përputhje me shtojcën 2.B dhe të magazinohen në mënyrë të tillë që të lejojnë hyrjen për qëllime inspektimi.
- 4.31 Mbetjet spitalore nuk duhet të presohen apo t’u nënshtrohen veprimeve të sforcuara mekanike pasi kjo dekarat lëshohet vetëm për procesin e
- 4.32 Në zonën e magazinimit të kontejnerëve me mbetje mjekësore duhet të ndalohej hyrja e personave të paautorizuar. Zonat e magazinimit duhet të kenë shenja paralajmëruese në dyert hyrëse, porta ose kapakë. Në zonën e magazinimit nuk duhet të lejohet hyrja e kafshëve dhe elementeve natyrore dhe të parandalohet krijimi i vendeve të shumimit ose burimit të ushqimit për brejtësit ose insektet. Ato, gjithashtu, duhet të jenë të rrethuara.

4.33 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Shtojca I, duhet t'i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.

4.34 Në dosjen e aplikimit për Leje Mjedisore, subjekti duhet të paraqesë:

- Vendin se ku do të depozitohet hiriq ë do të dalë nga inceneratori
- Llojet e filtrave që do të instalohen në shkarkimin në ajër (me foto, skica)
- Impiantin e trajtimit të ujërave të gjeneruara pas trajtimit me autoklavë (me foto, skica, planimetri)
- Markën e pajisjeve që do të kryejnë trajtimin e mbetjeve spitalore, Certifikatat e teknologjisë ISO, që plotëson kushtet dhe vërteton se autoklava dhe inceneratori janë funksionalë.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së", ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.


DREJTORI I PËRGGJITHSHËM I AKM  
EDISON KONOMI

MINISTRI  
BLENDI KLOSI





**Aneksi 1. Harta me koordinatat**



**Koordinatat GAUS KRUGER**

E	N
4417721.161	4551189.517